

djalit, ke »bjere tani ne tšike tamburait«, edë zuri djali ë i bij tamburait. Atjë nek ajó kasabá ish ne mbret, ke kiš ne vajz te vetem, edë ajó vajza s duaj te martonej; e kišne kerkulare nga šume mbreter te tjere, po ajó nuku duaj te mir nonë; i kiš ðene babait, ke »u nuku martonem pa maře atë djale, ke te me pelkën«, edë mbreti e kiš lenë ne kejj te saj, ke tšili t i pelkën, atë te mir. Atë vakt k i bij djali tamburait, ajó vajz e mbretit ish zgvar, edë si ndjeu tamburane, i foli mbretit ë i ðote: »O babá!« Edë mbreti j u-pergëg edë i ðote: »Tš do, moj bile?« I ðot ajó: »E ndien atë tamburane ke bie? u atë, ke i bie tamburait, atë dua burë; hoj tšale kloft, hoj vërberë, ðe sidó ke te jete, u atë dua«. I ðote ðe mbreti, ke »jotja te benet, po e mire iste, ke t e šomi, š neri ist ai«. Me sabá si seksi dila, dergón mbreti ë reðosne kaikene, ke te zijne nérine, k i bij tamburait, ë t e špijne ne mbreti; edë nerezite vane edë e zune edë e špune ne mbreti. Kapetani kaikese, si ndjeu, ke djálene e mori mbreti, u-tremb šume edë vate me perpara ne mbreti ë i ðote, ke »tš e do atë neri, k e kerkón? atë neri u e soła ne kaikë time, edë ai s ka berë ge«. I ðote mbreti kaikerit, ke »ti mos u-tremb, se u atë neri e dua per te mire, nuk e dua per te lig«. Mbi ató tase, ke ðoš mbreti me kaikerine, e sile djálene askeri, ke kiš derguar mbreti. Vajza si e pa djálene šume te búkure, ða me mende te saj ke »pse s ndëna te maře ketë djálene, ke iste i búkure si dieli, po i ðatše babait ke »do mař atë, k i bie tamburait?« Edë djali tamburane e kiš me vethe, po kiš ne tamburá ake te vógele, sa e fšehenej nene šetut, ë si škoi djali, ke i kðeu krèhete, atë herë vajza j a pa tamburán, ke e kiš nene šetule, edë u-gezua šume vajza. E špune djálene mbernda ne mbreti, edë mbreti u-ngre, e priti ne dera edë e mori e vuri ne vend, ë ndëni; ë e pjeli: »Ngaha je ti?« Edë djali i ða fšátine, ke ish. Atë herë mbreti i ðote kaikšut, ke »dili jašt ju te tjërete, se kam ne tšike taf me djale; edë ti«, i ðote kaikerit, ke »mos u-tremb, se u djálene e dua per te mire«. Aštú duale jašte giðe te tjërete, sa isne mbernda; mbeti mbreti me djale; i ðote mbreti djalit, ke »u djale s kam, kam veteme ne vajz, edë dua te te bij tij djale edë te te jap vájzene grua, ne te pelkéft vajza«. I ðote djali, ke »u jam ne djal i vërferë, s kam takát me zoterine tende, ke te mař vájzene tende«. Mbi atë taf, ke lafósešine mbreti me djálene, vete vajz e mbretit ë u špie kafë, edë i ðote djalit: »Mis erde«, edë i ða dórene ë u-zune dor me dore. I ðote vajza, ke »u tij te dua per burë; tani ti me do a jo?« Po djali